



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI**

**PROJEKT- URDHËR**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR.88, DATË 25.10.2011 TË KRYEMINISTRIT  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË SHËRBIMIT SOCIAL  
SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

Në Urdhërin Nr. 88, datë 25.10.2011 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror” të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 25 të Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes”.
2. Në pikën 26 të Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes”.
3. Në Skemën 2/18 bashkëlidhur Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës Korçë” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Korçë”.
4. Në Skemën 2/19 bashkëlidhur Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës Vlorë” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Vlorë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**